



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENE

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK & MENAXHIMIT FINANCIAR

KONSULTIM - PUBLIK

DRAFT

PROJEKT - BUXHETI

2024

Ju parqesim per konsultim publik Projekt- Buxhetin e vitit 2024, ky buxhet eshte viti I pare I Buxhetit Afat-Mesem 2024-2026

Korniza ligjore per hartimin e Buxhetit 2024

- Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji nr. 9936, 26.06.2008 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligjet vjetore të buxhetit të shtetit.
- Ligji nr. 10296/2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar
- Ligji 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

CFARË ËSHTË DHE CILAT JANË QËLLIMET E BUXHETIT

- Buxheti është tërësia e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve të bashkisë, i miratuar nga këshilli bashkiak;

... Por nuk është thjesht një përmbledhje e shifrave dhe treguesve financiarë....
- Dokument bazë i politikave, planifikimit dhe kontrollit;
- Instrument me funksione dhe qëllime të përcaktuara;
- kontratë ndërmjet qytetarëve dhe bashkisë;
- mjet komunikimi (me të cilin informohen qytetarët + grupet e interesit për zhvillimin e territorit, përdorimin e fondeve publike etj.;
- udhërrëfyes (identifikimi i kostos së çdo aktiviteti, produkteve që do të ofrohen, numrit të qytetarëve që do të përfitojnë, dhe niveli të punonjësve të kërkuar për të kryer aktivitetin);
- një mjet për matjen e arritjeve kundrejt objektivave apo premtimeve

Objektivat kryesore për buxhetin vendor të vitit 2024

Do fokusohet ne nje rritje cilesore te nivleit te sherbimeve ne komunitet,ne mirembajten e institucioneve shkollore , zhvillimin e kultures e sportit ne konsolidimin fiskal e financiar ku prioritet do te jete zgjerimi I baze te tatimpaguesve dhe shlyerja e nje pjese te konsiderueshme te detyrimeve te viteve kaluar me objektiv per te mos krijuar asnje detyrim te ri ne fund te vitit buxhetore .

Shperndarja dhe perdorimi ekonomik I burimeve financiare, transparencia, pergjegjesia dhe respektimi me rigorozitet I buxhetit, jane parimet kryesore qe Bashkia Tepelene merr parasysh ne hartimin e buxhetit.

CILAT JANE BURIMET E FINANCIMIT PER VITIN 2024 ?

1. Transferta e pakushtezuar	105,955 mije leke
2. Transferta e pakushtezuar sektoriale	100,934 mije leke
3. Te ardhura te brendeshme	65,000 mije leke

TOTALI I BURIMEVE FINANCIARE 271,889 MIJE LEKE

Nga te dhenat e mesipereme transferta e pakushtezuar ze 39 % te Buxhetit, transferta sektoriale 37 % dhe te ardhurat e brendeshme 24 %

Pra sic shihet kemi nje buxhet qe eshte kushtezuar nga transfetat e Qererise 76 % dhe vetem 24 % plotesohen nga burimet e brendeshme .

CILAT JANE KERKESAT BUXHETORE PER VITIN 2024 ?

Kerkesat buxhetore per vitin 2024 permbajne;

- **Misionin e Bashkise**
- Vetëqeverisja vendore siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:
 - a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
 - b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
 - c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
 - ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
 - d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
 - dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
 - e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

- Pershkrimin e programeve buxhetore
- Planifikimin e shpenzimeve per cdo program ,sipas artikujve,produkteve dhe aktiviteteve
- Treguesit faktik per vitin buxhetor paraardhes,treguesit e planifikuar per vitin buxhetovazhdim dhe per tre vitet e ardheshme

SI do te perdoret ky Buxhet ?

Shpenzimet		%
PAGA	146,526	54
SIGURIME SHOQERORE	23,952	8.8
SHPENZIME OPERATIVE	59,285	21,7
TRANSFERTA TE BRENDESHME	5,650	2
TRANSFERTA TE INDIVIDE	3,000	1,1
FONDE REZERVE	3,500	1,3
FONDI KONTIGJENCE	3,000	1.1
MBROJTJA CIVILE	10,876	4
SHPENZIME KAPITALE	16,100	6
TOTALI BUXHETIT	271,889	100

Programi buxhetor “Mbrojtja Civile “ ne total per vitin 2024 eshte progmuar ne Shumen 10,879 mije leke , 4 % te totalit Buxhetit .

SHPENZIMET KAPITALE ;

Per vitin buxhetor 2024 jane programuar 16,100 mije leke per shpenzime kapitale nga keto ; 10,500 mije leke nga transfertat e pakushtezuar dhe 5,600 mije leke nga ate ardhurat. ;

- Rikonstrksion fasada unaza veriore + lagjja Demokracia 1,800 mije leke
- Rikonstruksion rruge ne qytet + blloqe banimi 1,200 mije leke
- Rikonstruksion rruga e fshatit Mamaj 2,500 mije leke
- Rikonstruksion blloqe banimi (15 shttaori + kinemaja).. 1,200 mije leke
- Bashkefinnacionim i Objketit Rikonstruksion shkolla Avni Rustemi 6,000 mije leke
- Mbikqyrje objekti Shkolla 9 Vjecare A.Rustemi 1,000 mije leke
- Rikonstruksion Njesia Administartive Qender2,400 mije leke

STRUKTURA E SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE BUXHETOTE

Planifikim,menaxhim,administrim	90,296	33,1
Kujdes social çerdhe	6,031	2,2
Konvikti	7,415	2,7
Sherbimet publike vendore	26,085	9,6
Menaxhim I mbetjeve	21,030	7,7
Trashigimni kulturore	10,661	3,9
Arsim parashkollor	50,898	18,7
Arsim mesem (sek mbeshtetes)	5,469	2
Administrim Pyje -kullota	7,177	2.6
Permiresim – ujitje -kullim	3,304	1.2
Mbrojtja nga zjarri dhe shpetimi	17,051	6.3
Rrjeti rugeve rurale	9,132	3.6
Fond rezerve	3,500	1.3
Fond kontigjence	3,000	1.1
Mbrojtja civile	10,876	4
37TOTALI BUXHETIT	271,889	100

PLANIFIKIMI I TE ARDHURAVE PER VITIN 2024

Mbështetur në germën “f”, të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligjin 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, ligjin 8519 datë 30.07.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, i ndryshuar, ligjin 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar ligjin 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, Ligji 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore “

Bashkia Tepelene ka hedhur nje hap te rendesishme ne percaktimin e plot e te sakt te kapacitetit te saj fiskal nepermjet krijimit te Kadaster Fiskale

Po cilat jane parimet mbi te cilat jemi mbeshtetur per nje Administrim te mire te Kopetencave Fiskale ?

- **Përputhshmëria:** pagesat e përdoruesve janë të të njëjta me kostot e shërbimeve;
- **Drejtësia:** ngarkesa fiskale bazohet në aftësinë për të paguar;

- **Neutraliteti:** ngarkesa nuk duhet të ndikojë në eficiencën e shpërndarjes së burimeve në sektorin privat; taksat nuk duhet të favorizojnë apo diskriminojnë një grup tatimpaguesish kundrejt një tjetri;
- **Përgjegjshmëria:** duhet të jetë e qartë se sa duhet të paguajnë tatimpaguesit dhe si do të përdoren këto fonde nga bashkia;
- **Përshtatshmëria dhe stabiliteti:** të ardhura të mjaftueshme për të financuar shërbimet në mënyrë të vazhdueshme; të ardhurat duhet të jenë të parashikueshme dhe të qëndrueshme ndër vite;
- **Autonomia;** bashkitë duhet të kenë autonomi dhe fleksibilitet për të vendosur prioritetet e tyre;
- **Minimizimi i kostove administrative:** llogaritja, vlerësimi, mbledhja dhe administrimi i taksave apo tarifave nuk duhet të konsumojë kohe, resurse dhe energji të tepërta;
- **Thjeshtësia:** detyrimi tatimor duhet të kuptohet lehtësisht, ndërkohë që përjashtimet duhet të kufizohen vetëm për raste tepër specifike dhe me një arsye të qartë

Cili është perkufizimi ligjor i taksave e tarifave ?

- **Taksë vendore:** është një pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e bashkisë, e vendosur me ligj, dhe që paguhet nga çdo person që ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e bashkisë;
- **Tarifë vendore:** është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mire publike specifike të përdorur, apo të drejte të dhënë nga bashkia;
- **Niveli i tarifave vendore orientohet drejt kostos së ofrimit të shërbimit;**
- Në hartimin e buxhetit vjetor, bashkitë bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme;

I TE ARDHURA TE BUXHETIT TE PAVARUR GJITHESHEJ: 65,000 MIJE LEKE KU PERFSHIHEN:

A.	Te ardhura te trasheguara nga viti	2023	2,000 mije leke
B.	Te ardhura nga taksat vendore viti	2024	33,366 mije leke
C.	Te ardhura nga tarifat vendore viti	2024	23,814 mije leke
D.	Taksa te ndara	20234	5,820 mije leke

1. Të ardhurat nga taksat perfshihen si me poshte.

- a. Të ardhurat nga pasuria e paluajteshme, jane planifikuar 5,689 mije leke.
- b. Te ardhurat nga trualli jane planifikuar 498 mije leke.
- c. Te ardhura nga taksa mbi token Bujqesore jane planifikuar 900 mije leke .
- d. Te ardhura nga tatimi I thjeshtuar mbi fitimin jsne planifikuar 600 mije leke.
- e. Te ardhura nga parkimi dhe tregu jane planifikuar 250 mije leke.
- f. Te ardhura nga efektet ne infrastruktur nga ndertimet e reja jane planifikuar 23,,000 mije leke.
- g. Te ardhura nga zenia e hapseirave publike jane planifikuar 429 mije leke.
- h. Te ardhura nga tabele jane planifikuar 223 mije leke.
- i. Te ardhura nga shfrytezimi i lendes drusore jane planifikuar 1,172 mije leke
- j. Te ardhura nga taksa e kullotat jane planifikuar 595 mije leke.

Ne total ta ardhurat nga taksat vendore sic dhe e theksuam me larte jane planifikuar 33,366 mije leke qe ze 51,3 % % te totalit te te ardhurave te planifikuara

2. Te ardhurat nga tarifat vendore perfshihen si me poshte.

- a. Të ardhurat nga tarifa e pstrimit jane planifikuar 4,936 mije eleke.
- b. Te ardhura nga reklamat jane planifikuar 234 mije leke.
- c. Te ardhura nga tarifa e ndricimit jane planifikuar 3,554 mije leke.
- d. Te ardhuar nga leje transporti jane planifikuar 90 mije leke
- e. Te ardhura nga cerdhe dhe kopeshte jane planifikuar 840 mije leke.
- f. Te ardhura nga tarifa e gjelberimit jane planifikuar 2,785 mije leke..
- g. Te ardhura te tjera jane planifikuara 996 mije leke.
- h. Te ardhura nga ambulantet jane planifikuar 108 mije leke.
- i. Te ardhura nga Qeraja e tokes bujqesore jane planifikuar 1,575 mije leke.
- j. Te ardhura nga qeraja e kullotes jane planifikuar 5,630 mije leke
- k. Te tjera te ardhura nga qerat dhe (vodafon, amc etj) jane planifikuar 1,016 mije leke
- l. Te ardhura te tjera debitor.....3,550 mije leke

Ne total e te ardhurat te Bashkise tarifat jane ne Shumen 23,814 mije leke ose 36,6 % .

2. TAKSAT E NDARA

- a. Taksa vjetore e mjetve te perdorura4,200 mije leke

- b. Renta minerare 120 mije leke
 c. Tatim mbi te ardhurat personale.....1,500 mije leke

Taksat e ndara per vitin 2023 jane parashikuar ne Shumen 5,820 mije leke ose 8,9 % te ardhura te programuara.

Ne territorin e Bashkise Tepelene ushtrojne aktivitetin 521 subjekt n ate cilat

116 subjekte juridike,15 institucione publike dhe 390 subjekte persona fizik

Ne njesine Administrative Qender ushtrojne aktivitetin 28 subjkte nga keta 11 Juridikdhe 17 fizik.

Ne njesine Administrative Kurvelesh ushtrojne aktivitetin 10 subjekte fizik.

Ne njesine Administrative Lopes ushtrojne aktivitetin 9 subjekte fizik.

000/leke

Nr	Emertimi	Nr	Te ardhura te planifikuara
1	Subjekte Juridike	116	6.100
2	Institucione publike	15	350
3	Biznesi vogel	390	5.280
4	Total	521	11,730

PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE

Ne buxhetin e bashkise per vitin 2024 shpenzimet jane te parashikuara sipas funksioneve te Bashkise. Te percaktuara qarte ne legjislacionin perkates.

Keto shpenzime ju referohen dy kategorive ekonomike:

- Shpenzimeve korente
- Shpenzimeve kapitale

Shpenzimet korente ndahen ne :

- Shpenzimet e personelit
- Shpenzimet operative dhe mirembajtje
- Shpenzime te tjera

Funksionet baze ;

a.Funksionet ne fushen e infrastructures dhe sherbimeve publike

b.Funksionet en fushen e sherbimeve sociale.

c.Funksionet ne fushen e Kultures sportit she sherbimeve argetuese

d.Funksionet ne fushen e mbrojtjes mjedisit.

e.Funksionet ne fushen e bujqesise,zhvillimit rural ,pyjeve dhe kullotave publike,natyers e biodiversitetit.

f.Funksionet ne fushen e zhvillimit ekonomik vendor.

g.Funksione ne fushen e sigurise publike

Shpenzimet per funksionet e deleguara: Ne keto funksione perfshihen funksionet qe jane pergjegjesi e pushtetit qendror dhe qe ky pushtet I delegon me ligj njesise se qeverisjes vendore. Financimi I tyre behet nga buxheti I shtetit. Ne kete grup perfshihen shpenzimet per paga, sigurimet shoqerore, shpenzimet operative per gjendjen civile, QKB, Ndihma ekonomike etj.

SHPENZIMET E PLANIFIKUAR SIPAS PROGRAMEVE BUXHETOR

PROGRAMI ; 01110 PLANIFIKIM,ADMINISTRIM MENAXHIM

Nr	Emertimi I shpenzimit	Llog ekon	Totali	Grant	Te ardhura
1	Pagat	600	40,000	25,000	15,000
2	Sigurime shoqerore	601	6,680	4,310	2,370
3	Shpenzime operative	602	20,330	13,992	6,338
4	Transferta te Brendeshme	604	5,650	4,150	1,500
5	Transferta te Individ	606	3,000	1,500	1,500
6	Shpenzime kapitale	231	14,600	,000	5,600
	SHUMA		90,260	57,952	32,308

Mbeshtetje ligjore per pagat eshte Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.5.2023 Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore..... VENDIM Nr. 113, datë 1.3.2023 PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Perllogaritja e kontributit te sigurimeve shoqerore eshte bere ne baze te akteve ligjore ne fuqi, ku kontributi u punedhenesit eshte ne masen 16.7 %, kjo e ndare 15 % per sigurime shoqerore dhe 1,7 % per sigurime shendetesore

Per perdorimin e me eficence dhe ekonomi te burimeve financiare te vena ne dispozicion per shpenzime operative jane percaktuar normativat e harxhimit te materialeve te pastrimit, te veshmbathjes se Policise Bashkiake , si dhe normativat e harxhimit te karburantit e druve te

zjarrit për kalidat për ngrohje në të gjitha shkollat 9-vjeçare dhe të mesme si dhe karburantit për mjete administrates Bashkise dhe atë të Policise Bashkiake . Si dhe normativat e uniformave të puntoreve si dhe normative e harxhimit të karburantit për mjete teknologjik të pastrimit, kamionit vetshkarkues, mjetit të rëndë tip 'SKREP " Etj.

Të gjitha shpenzimet janë detajuara sipas klasifikimit ekonomik të miratuara nga Ministria e Finances dhe janë marrë në konsideratë .

1.-Detyrimet e palikujduara nga viti kaluar.

2.-Kerkesat me të domosdoshme për çdo zë të shpenzimeve duke u bazuar në kerkesat e çdo njesie shpenzuese dhe në normativat e miratuara për harxhimit e tyre.

3.-Nivelin e realizimit të një viti më parë

Detyrimet e prapambetura

"Detyrimet të prapambetura ndaj paleve të treta " nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV -ve të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat të aprovimit në njesinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degen e thesarit) nga data e pagesës specifikuar në kontratë , faturë ose sipas ligjit .

Evidentimi i faktit nëse njesia e vetqeverisjes vendore ndodhet në një nga rastet e vështirësive financiare në ligjin nr 68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore " është detyrë e vetë njesisë së vetqeverisjes vendore.

Njesia e vetqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi financiare kur vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj paleve të treta konstatohen dhe në muajin pasues dhe vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj paleve të treta rritet progresivisht mbi nivelin 25 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara.

"Minimumi i shërbimeve publike "është paketa e shërbimeve publike me të domosdoshme për të ruajtur normalitetin e funksionimit të njesisë së qeverisjes vendore në një nga rastet e vështirësive financiare të përcaktuar në ligjin nr 68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore "

Forma aktuale dhe niveli specifik i performancës së këtyre shërbimeve publike përcaktohet nga Keshilli i njesisë vetqeverisjes vendore brenda kornizës së përcaktuar me akte ligjore dhe nën ligjore sektoriale. Sipas nenit 33 të ligjit nr 139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore " ,njesitë e vetqeverisjes vendore janë përgjegjëse për haritimin e zbatimin e një sistemi të menaxhimit të performancës së shërbimeve publike,në bazë të standarteve vendore dhe /ose standarteve kombëtare minimale.

Plani dhe masat që do të merren

Plani financiar për rehabilitimin duhet të zhvillohet brenda kuadrit të përcaktuar nga plani i buxhetit vjetor dhe programi buxhetor afatmesëm i miratuar duke marrë në konsideratë trendet në dy vitet e fundit të periudhës së parashikuar të buxhetimit.

Masat qe do te merren duhet te synojne;

- Rritjen e te ardhurave vendore dhe perdorimin e fondit rezerve /kontigjence
- -Rishikimin e shpenzimeve buxhetore

Detyrimet e prapambetuar te bashkise ne fund te vitit buxhetor parashikohet te jene ne Shumen 27,000 mije leke e cila perben 10 % buxhetit te miratauar pra ne baze te vlersimit te bere jemi ne **situaten normale e gjendjes financiare.**

Per vitin buxhetor 2024 synojme qe ky raportr te jete te 5 % pra synojme qe me kete buxhet te likujdojme rreth 18,000 leke detyrime te vitteve te kaluara.

c. -Per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura shuma 17,500 mije leke nga keto

1. Mallra dhe sherbime 12,500 mije leke
2. Vendime Gjyqesore 1,500 mije leke
3. Investime 3,500 mije leke

duke mos krijuar asnje detyrim te ri pergjate vitit buxhetor

Ne kete projekt eshte parashikuar dhe nje ze shpenzimesh ne Shumen **,500** mije leke per te zbatuar detyrimet financiare qe rrjedhin nga vendimet gjyqesore per te cilat ato jane ngarkuar ose ngarkohen nga keto vendime ne perputhje me VKM Nr. 335 date 02/06/1998 , “per procedurat per zbatimin e vendimeve gjyqesore per detyrimet qe prekin buxhetin e shtetit”.

Shuma e detyrimit per vendime gjyqesore te formes prere me 30.11.2022 eshte **1,560,000 . leke**

Lista e kreditoreve per vendimet gjyqesore ne fund te vitit 2021

1. Perparime Shehu vendim gjyesor ceshtje pronesie (tregu) shuma 1,560,000 leke

Ujsjellesi sh a nuk ka derdhur ne buxhetin e Bashkise vleren prej **18,500.** mije leke e cila eshte taksat e tarifat qe ka mbledhur si agjent tatimor per familjet.

Jane projektuar si programe buxhetore me kodifikim te vecante (fondi rezerve dhe ai I kontigjences) nivlei I ketyre dy programve buxhetore eshte rreth 2,3 % te buxhetit te planifikuar

Fondi rezerve : krijohet duke u bazuar ne nenin 40 te Ligjit “139/2015 date 17/12/2015 “Per veteqeverisjen vendore dhe Nenit 6 te Ligjit Nr. 9936 date 26/06/2008, “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise “I ndryshuar per te perballuar shpenzimet e paparashikuara ne buxhetin e njesise te qeverisjes vendore.

Fondi I kontigjences: perdoret sipas percaktimeve ne vendimin per buxhetin vjetor te Keshilli te qeverisjes vendore, per te perballuar efektet e mosrealizimit te te ardhurave, nevojën e kryerjes se financimeve te reja dhe shtimin e financimit mbi fondet e miratuara ne programet ekzistuese

Mbrojtja Civile Eshte planifikuar ne Shumen **10,876 mije leke** si pjese e buxhetit te pavarur krahas financimit te qeverise si transferte e kushetuar.

FONDE PER KESHILLIN DHE KRYETARET E FSHTRAVE

Shperblimi mujor per antaret e Keshillit eshte 10% e pages se Kryetarit te Bashkise ndersa e kryetareve te fshatrave eshte 10 % e pages se Administratorit te Njesise -ne planin e buxhetit te vitit 2022 , ky fond ze 6,000 mije leke, .

Nga total i shpenzimeve operative te parashikuara per vitin 2024 do te perdoren me destinacion per " Keshillin Bashkiak " shuma prej 1,200 mije

VKB "Per Miratimin e planit te aktiviteve te Keshillit per vitin 2024

PROGRAMI ; KUJDESI SOCIAL Çeredhe Femijeve 10140.

Struktura organizative e ketij aktiviteti ndihmes te Bashkise eshte 6 punonjes.Fondet e vena ne dispozicion te ketij aktiviteti sherbejne per mbulimin r pagave, sigurimeve shoqerore si dhe shpenzimet operative me te domosdoshme:

NR.	FUNSIONET	G.T	ART	BUXHETI 2024	GRANT	TE ARDHURA
	Cerdhe	10140				
1	Pagat		600	4,140	3,040	1.100
2	Sig.shoqerore		601	691	506	185
3	Shp.operative		602	1.200	1,200	0
4	Shpenz.kapitale		231	0	0	0
	TOTALI			6,031	4,746	1,285

Mbeshtetje ligjore per pagat eshte Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.5.2023 Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore..... VENDIM Nr. 113, datë 1.3.2023 PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Shpenzimet per zerin "Furnizim me ushqime" , jane planifikuar ne baze te numrit te femijve qe frekuentojne cerdhen dhe Udhezimit Nr. 457 date 13.06.2018 "Per normativat e vendosur per personelin e cerdheve I ndryshuar

Keshilli Bashkiak mund te autorizojë Kryetarin e Bashkise te percaktojë listen emerore te 5 femijeve me nje prind te cilet jane ne kushte te veshtrira ekonomike .dhe do te trajtohen me ushqim ne kopshtin me dreke bazuar ne frekuentimin dhe kuoten ushqimore te miratuar ,shpenzime qe do te mbulohen nga buxheti i Bashkise

MIREMBAJTJE ZAKONSHME

Ne kete ze shpenzimeve jane parashikuar **11,550 mije leke**, te cilat do te perdoren per destinacionet e meposhtme :

6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	11,550
6025500	Mirembajtje paisjeve elektronike	300
6025300	Mirembajtje godine	3,000
6025300	Rikonstrukcion ambientet e arkives	250
6025600	Mirembajtje mjete e transportit	1,200
6025400	Riparim e mirembajtje ndricim rrugor	1,200
6025400	Hegje te inerteve dhe mbetjeve te tjera urbane	500
6025100	Punime sistemimi ne fushen e depozitim te mbetjeve	1,200
6025200	Mirembajtje ne varrezat publike	800
6025500	Mirembajtje te aparteve e paisje pika e transmetimit televiziv	400
6025400	Mirembajtje rruge RURALE	1,200
6025400	Mirembajtje rrjete kulluese e ujites	1,500

PROGRAMI :SHERBIMET PUBLIKE VENDORE 06260

Fondet e vena ne dispozicion sherbejne per mbulimin e pagave, sigurimeve shoqerore te punonjesve si dhe shpenzimet operative.

NR.	FUNSIONET	Programi	ART	BUXHETI 2024	GRANT	TE ARDHURA
	Gjelberimi, Dekor,Varreza etj	06330				
1	PAGAT		600	17,451	9,621	7,830
2	SIG.SHOQERORE		601	2,534	1,478	1,056
3	SHP.OPERATIVE		602	6,100	4,500	1,600
4	SHP.KAPITALE		231	0	0	0
	SHUMA			26,085	15,599	10,486

Mbeshtetje ligjore per pagat eshte Vendim i Keshillit te Ministrave nr. 328, date 31.5.2023 Per klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore..... VENDIM Nr. 113, datë 1.3.2023 PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

MENAXHIMI I MBETJEVE 05100

NR.	FUNSIONET	Programi	ART	BUXHETI 2024	GRANT	TE ARDHURA
	Menaxhim I Mbetjeve	05100				
1	PAGAT		600	7,082	2,517	4,565
2	SIG.SHOQERORE		601	1,183	733	450
3	SHP.OPERATIVE		602	12,765	10,885	1,880
4	SHP.KAPITALE		231	0	0	0
	SHUMA			21,030	14,135	6,895

Bashkia Tepelenë e kryen shërbimin e menaxhimit të mbetjeve vetë, nga Drejtoria e Sherbimeve, prane bashkise. Shërbimi i mbledhjes dhe transportit të mbetjeve shtrihet pothuajse ne te gjithë territorin e Bashkise

Venddepozitimi i mbetjeve per Bashkine Tepelene ndodhet ne fshatin Majkosh, eshte i vetmi vend-depozitim funksional .. Ndodhet ne nje distance 1.5 km nga qyteti, ne krahun e djathte te rruges nacionale Tepelene – Memaliaj,ne nje distance 1 km nga rruga nacionale Tepelene – Memaliaj. Me nje siperfaqe 4900 m², e miratuar me vendim te Keshillit Bashkiak, vendim nr. 7, te dates 24. 03. 1998.

Ne kete zone nuk ka rrjedhe të ujrave siperfaqesore por ka filtrime te ujrave nentokesore. Rrjet tubacioni të ujësjellës kanalizimeve te qytetit nuk ka ne afersi te ketij venddepozitimi. Përshkueshmëria e zonës është mesatare dhe struktura e tokes eshte nje perzierje argjile me zhavorre. Ky venddepozitim eshte ne nje zone te qendrushme dhe nuk ka rrezik kolapsi apo rreshqitje toke dhe nuk rrezikohet nga permbytjet e lumit Vjose ne piken me kritike te prurjeve. Persa i perket rrezikut te flores dhe faunes nga zjarret nuk paraqitet ndonje rrezik per demtime apo perhapje te zjarreve.

Nisur nga fakti qe Lumi Vjose eshte shpallur Parkm Kombetar eshte kerkuar zhvendosja e fushes se mbetjeve urbane e cila duhet te realizohet ne nje kohe sa me te shpejt mper te mos penguar proceset e tjera.

Nga matjet dhe studimet e kryera ne terren sasia e mbetjeve qe gjenerohen ne dite per banor eshte 0.7 kg/banor/dite per zonat urbane dhe 0.4 kg/banor/dit per zonat rurale. Sasia ditore qe grumbullohet eshte 5 – 6 ton/dit, si rrjedhoj sasia vjetore e mbetjeve eshte 2200 ton/vit.

Veprimtaritë e riciklimit dhe rikuperimit nuk janë të pranishme në zonë, ndërkohë që sektori joformal i riciklimit, nga ana tjetër, është i pranishëm, gjithsesi i kufizuar në një numër të vogël njerëzish të cilët mbledhin nga kontejnerët rrymat e riciklueshme të mbetjeve, kryesisht plastikë, qelq dhe metal.

Bashkia përcakton tarifë të veçuar të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve; ajo faturohet së bashku me tarifa të tjera vendore.

Tarifat e pastrimit për nivele të ndryshme të konsumatorëve, si familjet, bizneset dhe insitucionet, caktohen dhe propozohen nga bashkia dhe miratohen çdo vit nga Këshilli Bashkiak në paketën fiskale bashkë me taksat dhe tarifatat e tjera lokale. Tarifa familjare e pastrimit është një shumë e caktuar vjetore për t'u paguar nga familjet, ne zonat urbane është 1000 lek/vit kurse ne zonat rurale është 500 lek/vit. Të gjitha tarifatat si për familjet ashtu dhe për bizneset e qytetit të Tepelenës, faturohen dhe mbledhen nga Shoqeria Rajonale Ujesjelles -Kanalaizime Për NJA të tjera, janë autoritetet lokale të tyre, që nëpërmjet zyrës së taksave dhe tarifave mbledhin tarifatat e qytetarëve.

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve konsiston në mbledhjen e mbetjeve urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brenda kontenerëve publik si dhe rreth tyre, dezinfektimi i kontenerëve dhe vendit përreth me gëlqere dhe klor, transportimi i mbetjeve urbane me makinën teknologjike deri në pikën përfundimtare të depozitimit. Ky shërbim që ofrohet gjatë gjithë vitit shtrihet pothuajse ne te gjithë territorin e Bashkise

Sistemi aktual i pikave të grumbullimit të mbetjeve (PGM) përbëhet nga kontenerë metalik me rrota me volum 1.1 m³, dhe 1,7 m³të pozicionuar në anë të rrugëve në pika të përbashkëta publike miratuara paraprakisht nga autoritet bashkiake, te shperndara: ne qytet jane 70 kontenier, dhe ne zonat rurale 60 kontenier. Kostua e perafert per mbledhjen e menaxhimin e mbetjeve urbane është **4,275 leke / dite per ton** .

Duhet theksuar që bashkia nuk i ka problem rrymat e tjera të mbetjeve si ato gjelbra (shfrytëzohen nga vetë banorët), as mbetjet inerte (pasi përdoren për të mbushur gropa) dhe as ato spitalore pasi në zonë nuk ka sasi mbetjesh të tilla. Spitali ka lidhur kontrate me një kompani të licensuar për mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve spitalore.

Ne vitin buxhetor 2024 ne kemi planifikuar per menxhimin e mbetjeve nje fond rreth 21,030 mije leke ne shpenzimet korente.

PROGRAMI ; TRASHIGMNIA KULTURORE 08220

NR.	FUNSIONET	Programi	ART	BUXHETI 2022	GRANT	TE ARDHURA
	Qendra Kulturore	08250				
1	PAGAT		600	6,700	3.700	3,000
2	SIG.SHOQERORE		601	1,119	619	500
3	SHP.OPERATIVE		602	2,842	2,842	0
4	INVESTIME		231	0	0	0
	SHUMA			10,661	7,161	3,500

Mbeshtetje ligjore per pagat është Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.5.2023 Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të

funkionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore..... VENDIM Nr. 113, datë 1.3.2023 PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

TE TJERA ;

1. Do te merret me qira objekte per qender shendetsore ne Majkosh e fshatin Mezhgoran , e ne nj.Administrative gjithesej 3 objekte me vlere totale 360 mije leke
2. Do te merret me kontrate mjet transporti udhetaresh per transport ne varrezat Majkosh cdo te enjte e te diel nga ora 9 – 11 ne shumen 300 mije leke

Per seicilen nga procedurat do te zbatohen aktet ligjrore ne fuqi

TRANSFERTA TE SHOQATA “FUTBOLL KLUB TEPELENA”

Ne zbatim te kerkesave te FSHF, vendimit te Keshillit Bashkiak Nr. 28 date 26/08/2011, Vendimit Nr. 3325 date 22/05/2012, te Gjykates rrethit gjyqesor Tirane, Klubi I futbollit eshte regjistruar si person juridik I Shoqates “Futboll Klub Tepelena”, si organizate jo fitim prurese. Ne keto kushte ne zbatim dhe kerkesave ligjore jane organet e tjera, Asambleja dhe Drejtori ekzekutiv, qe drejtojne kete veprimtari. Ne zbatim te kerkesave te Ligjit ne do ti transferojme nga buxheti I Bashkise ne llogari te OJF “Futboll Klub Tepelena”, ne formen e transfertes te klubet ose asocacionet e sportit, shuma e parashikuar **__5,000_ mije leke.**

Ne zbatim dhe te rekomandimeve te KLSH financimi I FKT do te behen ne baze te nje preventive te sakt ku te percaktohet natyra e shpenzimeve dhe masa e te cilave do te mbulohen nga Buxheti I Bashkise. .

FUNKSIONET QE FINANCOHEN NGA TRANSFERTA PAKUSHTEZUAR SEKTORIALE

1. Konvikti 09230

1. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e vitit 2024, disa bashkive i janë akorduar fondet për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen fondet për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), për shpenzimet operative dhe për shpenzimet për investime.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Per vitin 2024 konvikti I qytetit funksionon ne baze te VKM Nr. 502 date 16/04/2008, "Per administrimin e konvikteve parauniversitar" eshte ne administrim te bashkise ku perballojme fondin e pagave, sigurimeve shoqerore si dhe shpenzimet operative.

Struktura organizative per vitin 2024 eshte 5 punonjes

NR.	FUNSIONET	G.T	ART	BUXHETI 2024	GRANT	TE ARDHURA
	Konvikti	09230				
1	PAGAT		600	2,708	2,708	0
2	SIG.SHOQERORE		601	452	452	0
3	SHP.OPERATIVE		602	4,255	4,255	0
4	SHP.KAPITALE		231	0	0	0
	SHUMA			7,415	7,415	0

2. PROGRAMI 09120 ARSIMI PARASHKOLLOR (KOPSHTETE E FEMIJEVE,EDUKATORE E PUNONJES NE QENDREN KLUTURORE TE FEMIJEVE)

Në transfertën e vitit 2024 njësitë të vetëqeverisjes vendore i janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Nr I punonjesve 53 vet

NR.	FUNSIONET	G.T	ART	BUXHETI 2024	GRANT	TE ARDHURA
		01.9120				
1	PAGAT		600	40,250	40,250	0
2	SIG.SHOQERORE		601	6,722	6,722	0
3	SHP.OPERATIVE		602	3,926	3,926	0
4	INVESTIME		231	0	0	0
	SHUMA			50,898	50,898	0

Shpenzimet operative ne Shumen 3,926 mije leke j nga keto jane mbuluar nga Buxheti I pavarur I Bashkise 1,200 mije leke per te rritur cilesine e sherbimit te mirembajtjes ne keto institucione .

3. PROGRAMI ARSIM I MESEM 09230 PUNONJESITE E SHERBIMEVE MBESHTETESE NE ARSIMIN ARSIMIN E MESEM

Nr I punonjesve 6

NR.	FUNSIONET	G.T	ART	BUXHETI 2024	GRANT	TE ARDHURA
		01.9230				
1	PAGAT		600	3,450	3,450	0
2	SIG.SHOQERORE		601	575	575	0
3	SHP.OPERATIVE		602	894	344	550
4	INVESTIME		231	0	0	0
	SHUMA			4,919	4,369	550

4. PROGRAMI 04260 ADMINISTRIMI I PYJE-KULLOTA

Në transfertën e vitit 2024, njësive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor

Nr I punonjesve 7

NR.	FUNSIONET	G.T	ART	BUXHETI 2024	GRANT	TE ARDHURA
		01.4260				
1	PAGAT		600	4,370	4,370	0
2	SIG.SHOQERORE		601	730	730	0
3	SHP.OPERATIVE		602	2,077	1,077	1,000
4	INVESTIME		231	0	0	0
	SHUMA			7,177	6,177	1,000

5. PROGRAMI 04240 PERMIRESIM UJITJE - KULLIMI

Në transfertën e vitit 2024 njësive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor

Nr I punonjesve 2

NR.	FUNSIONET	G.T	ART	BUXHETI 2024	GRANT	TE ARDHURA
		01.4240				
1	PAGAT		600	1,400	1,400	0
2	SIG.SHOQERORE		601	2,113	2,113	0

3	SHP.OPERATIVE		602	2,288	2,288	0
4	INVESTIME		231	0	0	0
	SHUMA			3,304	3,304	0

6.PROGRAMI 03280 SHERBIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPETIMI

Në transfertën e vitit 2024, të bashkive është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Ministria e Brendshme duhet t'ju dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Nr I punonjesve 14

NR.	FUNSIONET	G.T	ART	BUXHETI 2023	GRANT	TE ARDHURA
		01.03280				
1	PAGAT		600	12,650	12,650	0
2	SIG.SHOQERORE		601	2,113	2,113	0
3	SHP.OPERATIVE		602	2,288	2,288	0
4	INVESTIME		231	0	0	0
	SHUMA			17,051	17,051	0

7- PROGRAMI RRUGET RURALE 04520

Në transfertën e vitit 2024, njësitë e vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rural

Nr I punonjesve 11

NR.	FUNSIONET	G.T	ART	BUXHETI 2023	GRANT	TE ARDHURA
		01.4520				
1	PAGAT		600	6,325	6,325	0
2	SIG.SHOQERORE		601	919	919	0
3	SHP.OPERATIVE		602	388	388	0
4	INVESTIME		231	1,500	1,500	0
	SHUMA			9,132	9,132	0

Ne shpenzimet kapitale eshte parashikuar financimi I nje pjese te objektit Rikonstruksion rruge rurale Fshati Mamaj “ per vitin 2024 kjo shume eshte 2,500 mije leke

Te nderuar qyteteare !

JEMI TE HAPUR PER CDO SUGJERIM E PROPOZIM TUAJ PER TA SHQYRTUAR E PER TA BERE PJESE E BUXHETIT TE BASHKISE PER VITIN 2024

Ju faleminderit !

